



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 1 Mars 2022

Nr: 112

**V E N D I M**

**P Ë R**

**TËRHEQJE VËMENDJE NDAJ TV KOPLIKUT PËR TRANSMETIM REKLAMASH  
JASHTË INTERVALEVE KOHORE**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 84 pika 7, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**V Ë R E N:**

Neni 84, pika 7, e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përcakton fashën kohore për reklamat politike të subjekteve zgjedhore ndërmjet intervaleve kohore nga ora 15:00 deri 18:00 dhe nga ora 21:00 deri 24:00, të programit ditor.

Nga raporti i monitorimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, për datat 26, 27 dhe 28 Shkurt 2022 rezulton se, TV Kopliku ka transmetuar reklama jashtë fashës kohore të lejuar në Kodin Zgjedhor, respektivisht në datat 25, 26 dhe 27 Shkurt 2022.

**PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 84 pika 7, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**V E N D O S I:**

1. T’i tërheqë vëmendjen Tv Koplikut, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e transmetimeve të reklamave politike, jashtë fashës kohore të përcaktuar.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Ilirjan CELIBASHI**

